

## Politika të Sigurisë dhe Specifikat e Policimit në Komunitet në Shqipëri pas Rënies së Regjimit Enverist

PhD C. Artur Beu

University of Tirana, Albania

### Abstrakt

Pas një periudhe të trazuar që mbulon më shumë se tre dekada, besoj se duhet të ketë një fokusim më të madh rreth fushes së sigurisë urbane/sociale e cila ka qenë preh e zhvillimeve të larmishme politike dhe sociale që nuk bëjnë gjë tjetër vecse e dobësojnë perceptimin ndaj saj.

Në fushën e sigurisë urbane/sociale janë ndërmarrë nisma të shumta të cilat deri tani kanë sjellë përmirësime të rezultateve, por që nuk e kanë shënjestruar nëqendër objektivin. Jam i bindur që duhet të ketë një zgjidhje më të thjeshtë, por që gjithsesi kërkon një impenjim të konsiderueshëm si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror, por ajo që unë mendoj se është më e rëndësishme ka të bëjë me një ndërgjegjësim të vetë qytetarëve në lidhje me prodhimin e sigurisë urbane/sociale nga vetë ata me mbështetjen e autoriteteve shtetërore në përgjithësi dhe atyre ligjzbatuese në vecanti.

Qëllimi i këtij punimi është të kontribuojë në përmirësimin e perceptimit të sigurisë dhe në kuptimin më të thelluar të kësaj çështjeje kaq të lidhur me mënyrën e jetesës së qytetarëve dhe me ndikimin që ajo ka në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik-social të një vendi.

Metoda e përdorur në këtë punim është ajo e kërkimit sasior duke marrë në konsideratë literaturën e deritanishme dhe politikat e ndërmarra në fushën e sigurisë në Shqipëri në këto dekadat e fundit.

Në një mjedis të pasigurt nuk mund të ketë një jetë të qetë të qytetarëve dhe për rrjedhojë nuk mund të zhvillohen veprimtari sociale dhe ekonomike afatgjata. Në këtë perspektivë nuk mund të ketë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik me pasojat logjike që kjo situatë sjell. Pa një mjedis të sigurt nuk mund të pretendohet një hyrje në periudhën afatshkurtër në BE.

***Fjalë kyçe: Siguria, Policimi, Komuniteti, Integrimi.***

## Hyrje

Një model i ri i sigurisë sociale, duke marrë në konsideratë eksperiencat e vendeve evropiane. Policimi në komunitet apo një qasje e re më e kuptueshme që do të ofrohet nga ky punim, si ajo e policisë në afërsi, si një hap paraprak kundrejt komunitetit në Shqipëri. Më shumë komunikim, më shumë mbikëqyrje, më shumë afrim me pleqësinë, vegjëlinë dhe grupet vulnerabël.

Ky punim është realizuar në kuadër të një studimi bazë të vlerësimit të situatës në lidhje me politikat e ndërmarra në Shqipëri dhe në vecanti nga Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Shtetit për rritjen e kapaciteteve dhe efikasitetit të modelit të përzgjedhur si filozofi për t'i ofruar më shumë siguri qytetarëve të Shqipërisë. Por, analiza nuk do të kufizohet vetëm në këtë vlerësim, sepse do të ishte reduktive, ndaj është marrë në analizë i gjithë konteksti shqiptar duke u konsultuar me ekspertë të huaj dhe vendas e duke përdorur të gjithë literaturën përkatëse dhe dokumentacionet në dispozicion në këtë kontekst.

Për të qenë më të qartë, dëshiroj të sqarojmë qysh në fillim, se chështja e sigurisë së qytetarëve nuk është ekskluzivitet detyruës vetëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe i Policisë së Shtetit, por në të janë përfshirë një sërë institucionesh qendrore dhe lokale të cilët kanë të gjithë pjesën e tyre.

“Pranë bekimit kur një shtet buron nga një Kushtetutë e shkëlqyer dhe Sistem Ligjesh të përgjithshme, qëndrojnë ato avantazhe që rezultojnë në një plan të mirë-rregulluar dhe energjik të Policisë, i kryer dhe zbatuar me pastërti, veprim, vigjilencë, dhe maturi.

Pas kësaj varet, në një shkallë të madhe, qetësia, lumturia, liria e vërtetë dhe siguria e Popullit, që shumë punë dhe vëmendje ndoshta mund të mos duhen për të dhënë një pasqyrim të plotë të administrimit të brendshëm të Drejtësisë në të gjitha rastet e delikuencës penale.”<sup>70</sup>

Mbetet më shumë për të bërë në këtë drejtim dhe asnjë besoj se nuk do të mund ta mohojë këtë fakt; të gjithë dëshmojnë për rreziqet që jeta dhe prona kalojnë aktualisht nga numri i kriminelëve, të cilët, për shkaqe të ndryshme nuk janë duke vuajtur dënime për aketet e kryera ndaj individëve dhe publikut.

Siguria shfaqet si një element themelor në përvijimin e një jete të denjë për një qytetar të një vendi. Më kot do të mburrehim me liritë e fituara për të lëvizuar dhe vepruar nëse pjesa më e

---

<sup>70</sup> Patrick Colquhoun, 2011

madhe e komunitetit do të ishte e privuar nga kjo e drejtë për shkaqe të ndryshme të cilat jodomosdoshmërisht lidhen me mundësitë financiare.

Më kot do të mburrehim me sigurinë që ligjet tona na mundësojnë, në qoftë se ne nuk do të mund të shtriheshim për të pushuar qetësisht në banesat tona, për shkak të tmerrit të një vjedhjeje të mundshme, apo për pronën e kanosur nga marrja e dikujt që nuk zbaton ligjet, dhe për jetën tonë të ekspozuar ndaj rrezikut të pashmangshëm përpara afrimin e mëngjesit.

I papërsosur duhet të jetë plani ose zbatimi i tij, ose që të dy këto, në lidhje me Kodin tonë Penal, nëse krimet janë në rritje; nëse parimi moral pushon së qeni nën kontroll mbi një pjesë të madhe të popullit; dhe në qoftë se mikrokriminaliteti fillon të mbizotërojë në një shkallë të gjerë, sa që të ndikojë në pothuajse të gjithë pjesëtarët e shoqërisë të cilët kanë prona apo sende për të humbur.

Nëse, përveç kësaj, paqja e shoqërisë mund të kanoset nga pasojat e një jetë të shthurur nga pasionet vulgare të disa qytetarëve, me siguri që këtu kemi të bëjmë me një hetim interesant, i denjë për të qenë nën vëmendjen e çdo anëtarit inteligjent të shoqërisë, *nga çfarë vijnë këto sjellje negative të shumëta; dhe a ka një shërim për këto të këqija të akumuluar?*

Në zhvillimin e shkaqeve që e kanë prodhuar nevojën për siguri është e nevojshme së pari të analizohet sistemi i drejtësisë penale dhe puna e organeve të zbatimit të ligjit për parandalimin e krimeve dhe të sjelljeve që cojnë në akte kriminale.

Nëse shikojmë prapa në masat e ndjekura nga paraardhësit tanë dhe para kësaj periudhe, ne do të gjejmë se shumë ligje të mira janë bërë me qëllim të parandalimit, dhe për të siguruar sjelljen e mirë të personave që mund të kryejnë vepra. Shumë rregulla gjatë periudhës enveriste (1944-1991) kanë ndaluar dhe parandaluar vesin dhe sjellje të tjera të konsideruara të dëmshme në një shoqëri si ajo, e cila i përkiste jo më shumë se dy dekadave e gjysmëmë parë. Tashmë me kalimin në një shoqëri të demokratizuar shumë rregulla të mëparshme janë fshirë si me fshesë dhe pak rregulla janë themeluar për të kufizuar vesin, ose sjelljet e konsideruara të dëmshme në shoqërinë e sotme të cilat janë në rritje.

Në Shqipëri, policimi në komunitet ka lindur si plotësuesi më i madh strategjik i praktikave tradicionale të policimit. Me fokusin për të vendosur një partneritet polici-publik, ku e gjithë organizata e policisë, agjencitë publike dhe komunitetet bashkëpunojnë në mënyrë aktive për zgjidhjen e problemeve, policimi në komunitet paraqet një ndryshim në praktikë, por jo në objektivat e përgjithshme të policimit. Këto objektiva vazhdojnë të përqendrohen në: ruajtjen

e ligjit dhe qetësisë dhe rendit publik; mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit – veçanërisht të jetës; parandalimin dhe zbulimin e krimit; dhe dhënien e ndihmës dhe shërbimeve ndaj publikut për të ulur frikën. Partneriteti polici-publik, ofron një strategji për t'i arritur këto objektiva me më efikasitet dhe efektshmëri.

Koncepti dhe metoda e Policimit në Komunitet, siç u shpjegua këtu, ka të bëjë me organizatën e policisë. Meqenëse Policia është një nga palët më të rëndësishme në një partneritet mbi Sigurinë në Komunitet, zbatimi me sukses i Policimit në Komunitet është themeli për të garantuar komunitete më të sigurta.

Duke pasur parasysh këto parime mund të themi se filozofia e policimit në komunitet ka një bazë të fortë teorike për të qenë e suksesshme, por problemi si në cdo fushë qëndron në aplikueshmërinë e modeleve teorike. Mes të thënit dhe të bërit qëndron në mes një det i tërë thotë populli. Ajo që kam ndërmend, është pikërisht pëlhura ku këto parime do të thuren. Komuniteti ka pësuar një tranzicion që akoma sot vazhdon dhe struktura e komunitetit ka ndryshuar rrënjësisht.

### **Perceptimi i sigurisë publike**

Nëse i hedhim një shikim strukturës së Policisë së Shtetit dhe nëse do të kërkonim më konkretisht për struktura të posacme në lidhje me vënien në zbatim të filozofisë së policimit në komunitet, atëherë do të mbetemi të zhgënjyer, sepse, në asnjë rast do të hasni një strukturë të tillë të posacme. Filozofia e Policimit në Komunitet ngjet me një jetim, pa një organ i cili është përgjigjës për jetësimin e saj. Kjo filozofi duket se mbështetet vetëm në parime teorike dhe në direktivat e ardhura nga epërorët e policisë për të qenë sa më pranë një komuniteti që akoma nuk e ka kuptuar këtë prani të afërt të policisë.

Para ndërrimit të sistemit (viti 91) në Shqipëri kishte një realitet krejt të ndryshëm nga ai i sotmi sidomos në zonat metropolitane dhe veçanërisht në Tiranë. Ndjenja e përkatësisë komunitare ishte shumë e lartë kjo edhe për shkak të regjimit totalitar që kontrollonte tërë jetën e qytetarëve dhe në një farë mënyre për qytetarin e thjeshtë atë të linjësuar më rrymën e partisë realiteti ishte nga më të sigurtët.

Në një sondazh të kryer në vitin 2010 nga Instituti shqiptar për Studime Ndërkombëtare lidhur me temën e perceptimeve të shoqërisë shqiptare mbi demokracinë dhe shtetin pas njëzet vjetëve rezultoi se në fushat e ndryshme të jetës shoqërore:

Në kontekstin e lirive themelore pjesa dërrmuese e qytetarëve shqiptarë bie dakord se regjimi komunist nuk kishte liri të fjalës (49,7% shumë pak, 23 % pak), nuk kishte liri të shpalljes së fesë (63% shumë pak, 26% pak), dhunoheshin të drejtat individuale (29,8% tejmasë, 44% shumë), paprekshmëria e qytetarëve ishte e kanosur nga vetë shteti (18,6 % tejmasë, 50,5% shumë), dhe që vendi ishte i izoluar (40,3% tejmasë, 34.3% shumë).

Ndërsa në fushën e vlerave situata ishte krejt e kundërt. Sipas 77,5 % e qytetarëve të pyetur (34,2% tejmasë, 43,3% shumë) familja shqiptare ishte më e fortë gjatë regjimit. Përqindje të përafërta edhe lidhur me besimin reciprok të qytetarëve: 69 % e të anketuarve (21,5% tejmasë, 46,5% shumë) mendojnë se ishte më i lartë para 1990.

Nga ana tjetër në perceptimet e qytetarëve kushtet e jetesës janë përmirësuar gjatë njëzet viteve të fundit. 2,6% i konsideron të mira (1% shumë të mira, 31,6% të mira), 41,1% mesatare, 26,3% të këqija (2,5% shumë të këqija, 23,8% të këqija). Gërshëra e varfërisë për ata që kanë patur kushtë shumë të këqija gjatë regjimit është reduktuar me 25 pikë, duke kaluar ngal 27,2 në 2,5%, ndërsa përqindja e atij që jeton në kushte të këqija ka kaluar nga 43,8% në 23.8%. Mahnitës del fakti se vetëm 2,5% e të intervistuarve deklaroi se ka pasur kushte të mira jetese para vitit 1990 (1,2% shumë të mira, e 1,3% të mira).

Mendime më të ekuilibruara për sa i përket cilësisë së arsimimit, shëndetësisë. Niveli i arsimimit ka qenë i mirë para 1990 për 41% (19% shumë i lartë, 23% i lartë) e të intervistuarve, ndërsa kanë të njëjtin mendim për pas 1991 – 2010, 20% e tyre (5% tepër mirë, 15% shumë). Por për 42%, në këto njëzet vite cilësia është mesatare, kundrejt 23% që jep të njëjtin mendim për arsimin në regjimin komunist.

Më negativ është perceptimi rreth cilësisë së shëndetësisë publike. Për 52,3 % të qytetarëve (21,5% shumë pak, 30,8% pak), në njëzet vitet e fundit mund të thuhet se shtë e keqe. Të njëjtin përkufizim për periudhën komuniste e japin 30,9% (9,6% shumë pak, 21,2% pak). Në të njëjtën periudhë, 31,1% thotë se cilësia ishte mesatare, kundër 21,2% që shprehet kështu për njëzet vitet e fundit.

Interesante është e dhëna që tregon impenjimin e qeverive shqiptare për të garantuar kushte jetese të qytetarëve. 27% e të intervistuarve (4% tejmasë, 23% shumë) pohojnë se qeveritë janë munduar shumë pas 1990 për të garantuar një jetesë më të mirë, kundrejt, kundrejt 7 % (0% tejmasë, 7% shumë) që pohon po të njëjtën lidhur me periudhën komuniste. Nga ana tjetër këto reflektojnë të dhënat të atyre që thonë se qeveritë janë impenjuar pak: për 30% (13% fare

pak, 17% pak) gjatë njëzetviteve, dhe për 62 % (29% fare pak, 33% pak) gjatë regjimit komunist.

Vlerat më të përafërta në absolut janë ato që lidhen me impenjimet e qeverive shqiptare në garantimin e sigurisë së qytetarëve. 37% (12% tej mase, 25% shumë) konsideron këtë impenjim të lartë gjatë regjimit komunist, dhe 33% (5% shumë të lartë, 28% të lartë) e konsideron të tillë pas 1990. 29% shprehet për një impenjim mesatar para 1990, dhe 25% jep të njëjtën vlerë për njëzetvitet e fundit. Ndërsa për 33% (6% shumë pak, 27% pak), qeveritë shqiptare janë angazhuar pak lidhur me sigurinë para 1990, dhe 36% (8% shumë pak, 28% pak) mendon të njëjtën për periudhën pas 1990.

Krahas kësaj shtohen edhe gjykimet arbitrare të gjykatësve tanë në lidhje me krimet duke sjellë një minim në themel të parimeve dhe të vetë ligjeve në një shtet të së drejtës.

Mungesa e dënimeve të ndërmjetme dhe mungesa e mekanizmave për të recuperuar ata që kryejnë krime në shoqërinë tonë, ka sjellë një kundërvënje të drejtpërdrejtë mes krimet dhe organeve të zbatimit të ligjit ku këto të fundit ndejnë presionin e mungesës efektive të dënimeve duke humbur besimin dhe duke modifikuar sjelljen e tyre në drejtim të vetë kriminelëve.

Ashtu si ligjet administrohen aktualisht është me të vertetë për të ardhur keq, sepse pjesa më e madhe e kriminelëve që mbushin vendin, ndonëse janë dërguar para gjykatësve me prova shumë të kënaqshme, janë kthyer të lirë në publik vit pas viti; në këtë mënyrë kriminelët inkurajohen që të rinovojë praktikat e tyre, për shkak të shpëtimit nga drejtësia.

Në këto rrethana kemi përfituar një shoqëri me një mosbesim në sistemin e drejtësisë dhe në zbatimin e ligjit, e cila ka nevojë për ndërhyrje konkrete për t'iu rikthyer legalitetit. Nga ana tjetër kemi policinë me të gjithë sistemin e saj të përbërë nga burime njerëzore dhe financiare të mangëta. Por, besoj gjithashtu se problemi i sigurisë nuk varet vetëm nga mjetet, pajimet dhe niveli arsimor i punonjësve të policisë. Problemi i policisë në një shoqëri demokratike nuk është edhe aq një çështje e sigurimit të mjeteve e pajisjeve të një niveli të lartë teknologjik apo e rekrutimit të njërëzve me sa më shume vite të shkollës së lartë. Ajo që duhet të ndodhi në Shqipëri është një ndryshim domethënës i filozofisë së punës së policisë në mënyrë që ta shndërrojë profesionalizmin e policisë në një vlerë etike të rendit ligjor demokratik dhe jo në një arritje teknologjike<sup>71</sup> edhe pse kjo e fundit i shërben qëllimit.

---

<sup>71</sup> Jerome Skolnick, 1975

## **Policia e Shtetit dhe Policimi në Komunitet**

Sa i përket Policisë së Shtetit të Shqipërisë, ajo ka disa vite që zgjedhur qasjen e policimit në komunitet për të aplikuar një filozofi të re në lidhje me raportet me qytetarët. Në analizën e bërë duke marrë në shqyrtim Ligjin 9874 “Për Policinë e Shtetit” datë 4 qershor 2007, shikojmë se, Policimi në Komunitet është i parashikuar në nenin 122 të tij. Në mënyrë më të detajuar, Policimi në Komunitet është i trajtuar në Strategjinë e Policisë së Shtetit, 2007-2013 dhe në Strategjinë e Policisë së Shtetit 2014-2020, si edhe në Planin e saj të Veprimit. Në këto strategji i jepet një vëmendje e veçantë Policimit në Komunitet duke shpjeguar se, ai mundëson një partneritet mes Policisë me komunitetin duke ofruar një analizim të përbashkët të problematikave për të arrirë në përcaktimin e rrënjëve dhe të shkaqeve të tyre, në mënyrë të tillë që të jepen zgjidhje të mundshme duke synuar në rritjen e sigurisë sociale. Në bazë të këtij konceptimi të ri qëndron ai i bashkëndarjes së përgjegjësive mes institucioneve shtetërore, në këtë rast të Ministrisë së Punëve të Brendshme/Policisë së Shtetit me qytetarët në komunitet.

Bazuar në ligjin e lartpërmendur të Policisë së Shtetit, kjo e fundit duhet të konsultohet me një sërë aktorësh në të gjitha nivelet dhe chdo strukturë e veçantë e saj në 12 qarqet e Shqipërisë duhet të përgatitë plane vjetore lidhur me policimin në komunitet. Në strategjinë e re 2014-2020 vazhdon t’i kushtohet vëmendje policimit në komunitet duke synuar në ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe sa më të aksesueshme për qytetarët. Por, a ka funksionuar kjo filozofi deri tani? Këtë do të mundohemi të sqarojmë në këtë punim.

Përpyekja e këtij punimi do të jetë ajo e sjelljes së një qasjeje të re, duke ofruar një pikëpamje antropologjike të të jetuarit. Mendoj se, një trajtim i chështjeve nga brenda ofron një pikëpamje më të qartë të situatës së trajtuar. Në këto vite kam qenë i përfshirë në procese të raportimeve periodike të Policisë së Shtetit në kuadër të raportimeve të Progres Raportit, Planit të Veprimit të Integritimit Evropian apo raportimeve të tjera në kuadër të ndjekjes së prioriteteve të identifikuar nga Udhërrëfyesi për Shqipërinë në rrugëtimin e kësaj të fundit drejt Bashkimit Evropian. Në veçanti, është trajtimi i kapitullit 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria” ai që merret specifikisht me chështjet e sigurisë në Shqipëri. Sikurse edhe shihet qartë, edhe në konceptin evropian siguria lidhet në mënyrë të pandashme me drejtësinë dhe lirinë.

Sikurse tashmë dihet vendet që aspirojnë të bëhen pjesë e familjes së madhe evropiane duhet të për afrojnë kuadrin e tyre ligjor me legjislacionin Evropian. Detyrimi dhe angazhimi për për afroimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian, sanksionohet në nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Sipas këtij neni Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj

ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me legjislacionin evropian por njëkohësisht duhet të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.

Procesi i përafrimit të legjislacionit, përgjithësisht duhet kuptuar si më poshtë:

- Në kuptimin e gjerë juridik, do të thotë së pari transpozim i dispozitave të legjislacionit evropian në legjislacionin kombëtar, së dyti zbatimin në praktike të këtyre dispozitave të këtij legjislacioni nga autoritetet kombëtare publike kompetente si dhe së treti garantimi i zbatimit në praktikë i këtij legjislacioni nëpërmjet gjykatës apo dhe agjencive të tjera zbatuese ligjore.
- Në terma praktike, është një nga treguesit e progresit të vendit drejt Integritimit Evropian dhe përafrimi është sasia dhe cilësia e akteve ligjore kombëtare që transponojnë dispozita të legjislacionit evropian, si dhe prova për zbatimin efektiv të tyre në praktikë.

Ky përafrim legjislacioni për Shqipërinë ka filluar që me nënshkrimin e MSA-së dhe do të realizohet në dy faza tranzitore. Gjatë fazës së parë të periudhës tranzitore prej dhjetë vjetësh, përafrimi i legjislacionit do të mbulojë disa elementë themelorë të acquis-ë në fushën e tregut të përbashkët dhe në disa fusha të tjera që kanë të bëjnë me tregtinë. Faza e parë do të mbulojë përafrimin e legjislacionit në fushat lidhur me konkurrencën, me pronësinë intelektuale, me prokurimet publike, me standartizimin dhe certifikimin e produkteve. Faza e dytë e periudhës së tranzicionit do të mbulojë fushat e tjera, të cilat nuk përfshihen në fazën e parë.

Përveç MSA, procesi i përfarimit të legjislacionit në Shqipëri realizohet duke u bazuar në aktet nënligjore të mëposhtme:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 486, date 25.07.2012 mbi miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-s (2012-2015) dhe përcaktimin e përgjegjëseve institucionale për përafrimin në legjislacionin shqiptar të çdo akti të Bashkimit Evropian (i cili përditësohet çdo vit);
- Vendim nr 201 datë 29.3.2006 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”;
- Vendim nr.4 data 7.1.2009 një shtesë në Vendimin nr.584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.



Gjithashtu, janë analizuar dhe vlerësuar politikat e ndjekura deri tani në lidhje me sigurinë dhe për rrjedhojë edhe të analizoj filozofinë e policimit në komunitet në mënyrën se si është parë ajo dhe se si mund të përshtatej akoma më mirë në një kontekst të ri dhe gjithnjë në lëvizje për Shqipërinë. Në kontekstin shqiptar kërkohet një përshtatje e filozofisë së policimit në komunitet për shkak edhe të një konteksti krejt ndryshe nga ai i vendeve të tjera ku kjo filozofi duket se është aplikuar me sukses.

Duke u bazuar edhe në studimet e kryera në bashkëpunim me disa projekte që synojnë në rritjen e efektivitetit të punës së Policisë së Shtetit duke asistuar në mënyrë të drejtpërdrejtë këtë të fundit, ky punim ka si qëllim të ofrojë disa zgjidhje të mundshme në mënyrë që të rritet kapaciteti i Policisë së Shtetit për t'iu afruar më shumë qytetarëve dhe për të ndryshuar një konceptim të trashëguar nga e kaluara si një polici e cila nuk operon bazuar në kalljen e frikës, por si një polici e modernizuar e cila është pjesë përbërëse e komunitetit. Policia e re është në shërbim të qytetarëve duke patur aftësinë e krijimit të partneriteteve efikase nëpërmjet një qasjeje krejt të re. Policia e konceptimit perëndimor është e aftë të krijojë marrëdhënie me të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e ofrimit të një mjedisi më të sigurt të mundshëm për qytetarët e saj, duke u shndërruar në një pikëmbështetje për të gjithë qytetarët. Policia e re duhet të jetë e aftë të operojë krah për krah me shërbimet e tjera policore në dobi të së mirës së përbashkët të qytetarëve. Në këtë mënyrë Policia do të jetë e aftë të parandalojë pa qenë nevoja e reagimit pas ndodhjes së ngjarjeve, sepse, duke operuar në afrimet me komunitetin do të jetë e aftë të zbulojë në kohë lindjen e fenomeneve kriminale. Kjo polici e konceptimit të ri do të jetë e aftë të identifikojë çdo ndryshim në sjelljen e qytetarëve duke u fokusuar më shumë në të rinjtë dhe në ata që asnjëherë më parë kanë qenë pjesë e vëmendjes së policisë. Policia e konceptimit të ri perëndimor është e përkushtuar në ruajtjen e balancave sociale duke respektuar të drejtat e minoriteteve, të identiteteve fetare, identiteteve gjinore, grupeve më të dobëta në komunitet në zbatim të filozofisë së adoptuar. Kjo sjellje e re e policisë do të vijë si rezultat e reformave të duhura duke filluar qysh me Ligjin e Ri për Policinë e Shtetit dhe rivendosjen e institucionit arsimor të Akademisë së Sigurisë<sup>72</sup> dhe me ndihmën e trajnimeve të përshtatshme për të vënë në zbatim filozofinë e policimit në komunitet e cila sipas këtij punimi do të ofrohet në një qasje tjetër më të përshtatshme në kontekstin shqiptar.

Për t'u përshëndetur janë iniciativa si ajo e qeverisë Suedeze me programin e policimit në komunitet dhe me projektet pilote të ristrukturimit të komisariateve të policisë duke u ofruar

---

<sup>72</sup> A. Beu 2012

qytetarëve zyra pritjeje më mikpritëse dhe duke iu ofruar atyre shërbime që më parë nuk jepeshin. Në këtë mënyrë shpresohet të rikthehet besimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve tek policia. Programi SACP ka ndikuar në kryerjen e punës së Policisë përmes dy nga komponentëve e tij (menaxhimi i performancës dhe partneriteti), dhe në anën tjetër ka marrë një qasje pak më tradicionale në komponentin e tretë të lidhur me dhunën në familje.

Risite e sjella lidhen me përdorimin e perceptimit të publikut si një mënyrë alternative për matjen e performancës së policisë. Kjo qasje ka përfshirë **Sistemin e Matjes së Sigurisë në Komunitet** si mjet informues në hartimin e strategjive dhe planeve të punës në njësi të vogla policore.

Skema e Granteve të Vogla si projekt ka mundësuar krijimin e një hapjeje të konsiderueshme me publikun në përgjithësi dhe me rininë dhe shtresat e marginalizuara në veçanti. Përveç kësaj, nëpërmjet ndërhyrjes në sallat e pritjes për qytetarët, synohet një ndryshim tërësor i imazhit të PSH dhe përmirësimi i marrëdhënieve me publikun e gjerë.

Menaxhimi i performancës ku është përfshirë zhvillimi i anketimeve dhe studimeve të shumta. Qëllimi është ai i matjes së perceptimit të publikut për sigurinë e tyre personale, tendencat e krimit dhe performancën e Policisë së Shtetit. Gjetjet kanë shërbyer për të gjeneruar diskutime se si mund të ndryshoheshin perceptimet negative dhe se si mund të përmirësohej puna e policisë në mënyrë më efektive.

Si një risi pozitive përmendet edhe studimi për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës seksuale në Shqipëri. Ky studim ka dhënë rekomandime të klasifikuara në 5 grupe: a) për komunitetin rom, b) për komunitetin LGBT, c) për gratë viktimat të dhunës, d) për fëmijët, dhe në fund e) për të moshuarit.

**Sallat e pritjes në komisariatet e policisë, mendoj se kanë patur një impakt shumë të rëndësishëm në përmbushjen e misionit dhe detyrave që ka policia është përmirësimi i marrëdhënieve të komunikimit nëpërmjet shërbimeve që ofron Policia e Shtetit për qytetarët.**

Për përmirësimin e besimit, transparencës dhe shërbimeve që ofron policia për qytetarët në Drejtoritë dhe Komisariatet e Policisë po funksionojnë **Z.SH.Q Zyrat e Shërbimit për Qytetarët.**

Realizimi i shërbimeve për qytetarët nëpërmjet këtyre zyrave do të rris besimin e qytetarve të policia për të kërkuar ndihmë, do të ndikojë në uljen e treguesve të vetgjyqësisë e deri në parandalimin e fenomeneve korruptive në rrëdhët e vet organizatës së policisë.

**Polici virtual (polici në facebook) ka qenë një tjetër risi.** Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë dhe Komisariatit Nr . 2 (si vlerë e shtuar me projektin sallën e pritjes) në bashkëpunim me EMP ka filluar përgatitjet për pilotimin konceptit të “policit virtual apo policit në faqen Facebook. Ky është një koncept i policimit në komunitet e cila është duke u përdorur me sukses në disa vende të BE . Faqja e Facebook do të përdoret për të shpërndarë mesazhe mbi sigurinë si dhe për parandalimin e krimit. Publiku mund të përdorë platformën për të bërë pyetje punonjësit të Policisë dhe/ose për të njoftuar ata në lidhje me çështjet e rendit.

Policia e Shtetit është duke zbatuar programin “Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme”. Kjo iniciativë ka filluar në **Nëntor 2009** në DPQ Tiranë, takim i iniciuar dhe zhvilluar nga Programi ICITAP, përfaqësues të Gardës Kombëtare të Neë Jersey dhe Drejtues të DPPSH. Programi është mundësuar nga Zyra e Bashkëpunimit për Mbrojtjen (*Office of Defense Cooperation ODC-Ambasada Amerikane Tirane*) nëpërmjet Programit të Partneritetit midis Shqipërisë dhe Shtetit të Neë Jersey-it (*State Partnership Program-SPP*) me bashkëpunimin e Gardës Kombëtare të Neë Jersey- it, Programit ICITAP (*Ambasada Amerikane Tiranë*), Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorive të Policisë së Qarqeve dhe Drejtorive Arsimore Rajonale. Ky program erdhi, pas një **vleresimi** të situatës së përdoruesve të drogave në Tiranë, dhe **synon** në përgatitjen dhe formimin e fëmijëve të moshave 12-13 vjeçare, të cilët kur të përballen me fenomen negative të duhanit, alkoolit, marijuhanes etj, të jenë në gjëndje t`i thonë në mënyrë të vendosur “*Jo drogave dhe substancave te tjera te rrezikshme*”, kur mund t`ju ofrohet këtyre ose miqëve të tjerë që kanë pranë. Ky program përfshin trajtimin e tre temave mesimore, Alkolit, Duhanit dhe Mariuhanes, me mbas vazhdon me konkurset e vizatimeve, ku nxenesit shprehin idete për duhanin, alkolin dhe Marjuanen dhe mbyllet me organizimin e një kampusi ku marin pjesë nxënësit me vizatimet më të mira.

### **Rekomandime**

- Rekomandimi i përgjithshëm thekson nevojën për një strategji më të mirë komunikimi me publikun e gjerë.
- Procesi i përafrimit të legjislacionit shfaqet themelor në mundësimin e zbatueshmërisë së ligjit.

- Konsultimi me aktorët në të gjitha nivelet dhe chdo strukturë e vechantë e Policisë së Shtetit në të gjithë territorin e Shqipërisë të përgatitë planet vjetore lidhur me policimin në komunitet apo me policimin në afërsi dhe matja e zbatueshmërisë së tyre të kryhet nëpërmjet sondazheve dhe pyetësorëve ku universitetet të bëjnë pjesën e tyre të studimit.
- Partneriteti me administratorët lokalë shfaqet një domosdoshmëri në punën e përditshme të policisë.
- Vazhdimi i programeve frytsjellëse si ato të përmendura në këtë punim do të sjellë një rritje të besimit tek qytetarët dhe një rritje të efikasitetit të punës së policisë duke sjellë një rritje të perceptimit të sigurisë në vend.
- Krijimi i figurave të qëndrueshme dhe i strukturave përkatëse në stacionet e policisë të cilat kanë si detyrë kryesore policimin në komunitet, pasi aktualisht nuk gjenden të tilla dhe procesi i policimit në komunitet has problematika të përgjegjësive së detyrës.
- Zbatueshmëria e ligjit dhe e drejtësisë mbetet themelore në ndërtimin e një shteti demokratik.
- Ndjekja e prioriteteve dhe plotësimi i detyrave të përcaktuara nga Bashkimi Evropian janë një domosdoshmëri për rrugëtimin e integritit në BE.
- Krijimi i një kulture të bashkëndarë nga të gjithë qytetarët do të sjellë një rritje të ndërgjegjësimit dhe një kuptim ndryshem të sigurisë në vend.

## **Referenca**

A.Beuf, International Conference on Sustainable Development 2013, “Relationship between the police educational formation system and public security” ICSD2013

A. Beuf, Reforma të reja në fushën e sigurisë urbane në Shqipëri, 11-12 Dhjetor 2012, Shkup 2012

A. Beuf, International Conference on Sustainable Development 2013, “Relationship between the police educational formation system and public security” ICSD2013

A. Beuf, Shtetformimi dhe nacionalizmi shqiptar si çështje të sigurisë kombëtare, shtator 2013, “Politikja”

Selmini R. Editore: Il Mulino, Marzo 2004, La sicurezza urbana;

Antonio Gagliardo Editori Riuniti Marzo 2006, La sicurezza minacciata. Criminalità transnazionale e terrorismo nell'Europa di oggi;

Botimet Toena Tiranë, 2002, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim IDN Polici - Komunitet së bashku për ndryshim;

Strategy of the State Police 2015-2020, drafted and sent for approval to the CoM;

Cross-cutting Strategy on the Fight against Organized Crime, Illicit Trafficking and Terrorism 2013 – 2020 and its Action Plan 2013-2016, approved by Decision of CoM no. 663, dated 17.07.2013. In November 2014, the CoM approved an addendum to the CoM Decision “On the Adoption of the Inter-institutional Strategy on the Fight against Organised Crime, Terrorism and Illicit Trafficking 2013-2020, and the Action Plan for 2013-2016;

The Strategy for Combating Trafficking in Persons and Action Plan 2014-2017, approved by CoM, November 2014;

National Strategy against Narcotics 2012 – 2016 approved by Decision of CoM no. 403, dated 20.06.2012;

Cross-cutting Strategy on the Fight against Terrorism 2011-2015 and its Action Plan approved by Decision of CoM no.675, dated 06.07.2011;

Strategic National Document on the Investigation of Financial Crime approved by Decision of CoM no. 1077, dated 27.10.2009;

National Road Safety Strategy 2011 - 2020 "and" Action Plan for Road Safety 2011 - 2015 ", adopted by Decision of CoM. 125 dated 23.02.2011.

National Action Plan on the Fight against Trafficking of Vehicles, 2012 – 2014, Protocol no. 391, dated 24.01.2012;

National Action Plan against Trafficking of Works of Art and Culture, 2012 – 2014, approved by Decision of CoM, no. 917, dated 28.12.2011.

National Strategy on Integrated Border Management and its Action Plan (Cross-cutting Strategy 2014 – 2020) adopted by the Council of Ministers with Decision No. 119, dated 5.3.2014;

Migration Profile in the Republic of Albania 2013: adopted at the Council of Ministers with decision No. 857, dated 10 December 2014;

Road Map on 5 key priorities recommended by the European Commission, 2013 (*Priority 3: Fight against corruption; Priority 4: Fight against organized crime*), approved by Decision of CoM no. 330, dated 28.05.2014;

“The national Anti-corruption Strategy and its Action Plan 2015-2017”, March 2015,

CoM no. 461, dated 09.06.2010, The Strategy for the Reintegration of Returned Albanian citizens 2010-2015;

Decision of CoM no. 760, dated 01.09.2010 “The national strategy of intellectual and industrial property 2010-2015”